

Glauk Konjufca

Ministër për Punë të Jashtme dhe
Diasporë, Qeveria e Republikës së
Kosovës

Vlora Dumoshi

Ministre për Kulturë, Rini dhe
Sport, Qeveria e Republikës së
Kosovës

E nderuara Ministre Dumoshi,

I nderuar Ministër Konjufca,

Fillimisht ju urojmë për emërimin tuaj në krye të ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Ministrisë së Jashtme gjegjësisht.

Duke iu dëshiruar punë të mbarë, më lejoni që t'i ngrisim disa çështje të cilat Grupi për Balkan i ka evidentuar, duke përfshirë të gjitha aspektet e Bashkëpunimit Rajonal

Grupi për Balkan në mënyrë të vazhdueshme ka punuar në rajon, me qështjet e bashkëpunimit rajonal dhe iniciativat rajonale.

Ju kërkojmë që qeveria dhe institucionet e Kosovës fuqishëm të rrisin prezencën në iniciativat dhe programet rajonale. Të dërgojnë nivele të përfaqësimit të drejtë.

Në veçanti, ju lusim që me ngulm të insitoni që Kosova të marrë dhe udhëheq me sa më shumë prej tyre dhe që Kosova dhe Prishtina të bëhen seli për disa prej tyre.

Në këtë aspekt, do të ketë ndryshime në udhëheqjen e disa prej tyre këtë vit dhe ju inkurajojmë që:

1. Me ngulm të insitoni marrjen e udhëheqjes së RYCO-s apo edhe më e rëndësishmja të WBF (Western Balkans Fund). Ju lus të loboni që udhëheqesi i ardhshëm i WBF-it të vie nga Kosova, ministra e Jashtme në këtë rast.
2. Shoqëria civile ka lancuar iniciativën e krijimit të Think-tank Network për Balkanin Perendimor dhe nëse miratohet nga bordi i WBF-it, qeveria të inistoj me çdo kusht që selia apo udhëheqja fillestare e saj të mirret nga Kosova.

Në shumicën e këtyre iniciativave rajonale, kërkohet koordinim i madh i sektorëve të qeverisë. Në veçanti, Minsitritë e juaja luajnë rol kyq. Me detajisht informata mund të gjinden në raportin e Grupit për Balkan për Samitin e Berlinit, të bashkangjitur.

Prandaj ju lusim që të shtoani maksimalisht përpjekjet për të rritur rolin e Kosovës në rajon. Grupi për Balkan është i gatshëm të ofroj mbështetje të madhe për qeverinë dhe iniciativat rajonale. Megjithate lobimi, emërimet duhet të vinë nga ju.

Sinqerisht,

Naim Rashiti, Drejtor Ekzekutiv
Në emër të ekipit të Grupit për Balkan
Balkans Policy Research Group
Qamil Hoxha, 29, nr.7
10000, Prishtinë